

Strategjia për informim dhe marrëdhënie me publikun e Kuvendit të Kosovës

Strategjia për informim dhe marrëdhënie me publikun e Kuvendit të Kosovës bazohet në parimin që ndarja e informatave është element i rëndësishëm i përforcimit të Kuvendit duke e ndërlidhur më mirë degën ligjvënëse me njerëzit që ajo i përfaqëson, duke e rritur besimin dhe duke e fuqizuar institucionin.

Synimi i strategjisë është që ta **rrisë sasinë dhe cilësinë e informatave në dispozicion të publikut** në lidhje me punën e Kuvendit, për të avancuar kontributin e publikut në proceset ligjvënëse dhe mbikëqyrëse, duke e përmirësuar kështu edhe reputacionin e Kuvendit.

Strategjia për ndërtimin e urave të komunikimit ka pesë komponentë: mesazhin kryesor; rritjen e rrjedhës së informatave; përmirësimin e përafrimit me publikun dhe të qasjes së publikut; përmirësimin e marrëdhënieve me mediat; dhe ndërtimin e kapaciteteve të Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun (ZMMP) dhe punonjësve tjerë të Kuvendit.

Kjo strategji paraqet një pjesë integrale të Planit strategjik të veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për 2011-2018, dhe është në vijë të drejtë me synimet kryesore strategjike të Kuvendit. Strategjia zhvillon veprime në kuadër të synimit 8.1 të Planit Strategjik që përcakton punën e Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Planifikimi dhe veprimi për synimet e informimit dhe marrëdhënieve me publikun mund të fillojë menjëherë dhe mbulon periudhën kohore 2012-2014.

A) Mesazhi kryesor

Rekomandim: Të hartohet një mesazh kryesor për Kuvendin që do të theksojë rolin, qëllimin dhe përkushtimin ndaj publikut.

Kuvendi i Kosovës duhet të zhvillojë një mesazh kryesor, mbi të cilin do të bazohen të gjitha komunikimet dhe marrëdhëniet ndërmjet publikut dhe Kuvendit. Pa një mesazh të njëjësuar, as deputetët e as publiku i gjerë nuk mund të ketë pasqyrë të qartë të rolit që Kuvendi e luan në jetën politike.

Mesazhi kryesor shërben si bazë për publikimet e Kuvendit, komunikatat për shtyp, faqen e internetit, aktivitetet e përafrimit me komunitetin, fjalimet, intervistat dhe artikujt. Mesazhi bëhet imazhi i Kuvendit dhe e informon anëtarësinë mbi atë se si duhet të mendojnë për veten dhe punën e tyre.

Mesazhi qenësor do të duhej të tingëllonte, duke pasqyruar një garanci për opinionin, që Kuvendi mbron interesat e të gjithë qytetarëve, duke vënë theksin në rolin e Kuvendit në shtimin e demokracisë dhe zbatimin e ligjeve, që është një institucion që përpiqet të plotësojë të gjitha kërkesat e shoqërisë.

Një fushatë themelore e mediave dhe afrimit me publikun e ndërtuar mbi këtë mesazh kryesor, duhet nisur nga Kuvendi për të edukuar publikun për rolin e Kuvendit, rëndësinë e tij dhe kontributet konkrete të tij për Kosovën.

B) Rritja e rrjedhës së informatave

Duhet përmirësuar sasia, cilësia dhe saktësia kohore e informatave të Kuvendit për publikun.

Metoda më e lehtë dhe më efikase, për publikimin e informatave është përmes faqes së internetit të Kuvendit. Shpejtësia është kritike pasi që gjuha e një projektligji që është në proces të miratimit – bashkë me dokumentet tjera përcjellëse të punës – është e rëndësishme për publikun, mediat apo shoqërinë civile, të cilët mund të duan të ofrojnë kontributin e tyre në projektligje.

Reformimi, përmirësimi dhe racionalizimi i faqes së internetit

Udhëzimet për faqet elektronike parlamentare nga Unioni Ndërparlamentar ofrojnë një numër idesh të mira mbi informatat që duhen paraqitur në një faqe interneti. Nuk ka ndonjë zgjidhje të përkryer për të gjitha faqet. Më poshtë, është dhënë një numër fushash për t'u marr në konsideratë, të cilat synojnë t'i avancojnë informatat në faqe, ta bëjnë më të lehtë sigurimin e kopjeve të legjislacionit, agjendave, përmbledhjeve të veprimeve të Komisioneve, teksteve të dokumenteve të komisioneve, si dhe mbi atë se çfarë kanë thënë deputetët dhe si kanë votuar, bashkë me historinë dhe faktet e institucionit.

Për implementim të masave të përmendura më poshtë, Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun duhet të punojë ngushtë me Divizionin për Teknologji Informative.

- 1. Hollësitë e rendit të ditës** – Derisa rendi i ditës i secilës seancë plenare dhe komisioneve ofrohet në faqen e internetit para secilës seancë, dokumentet që do të diskutohen duhet të jenë të lehta për t'u gjetur. Merrni parasysh krijimin e lidhjeve me dokumente nga rendi i ditës elektronik. Dokumentet, kurdo që janë në dispozicion, duhen postuar në rendin elektronik të ditës për të përmirësuar transparencën publike të legjislacionit dhe pikave tjera në Kuvend
- 2. Puna e Komisioneve** – komisionet janë fuqia shtytëse e procesit ligjvënës. Për t'i dhënë profil më të lartë komisionit, faqja e internetit duhet të përfshijë në secilën faqe të komisioneve
 - **Mandatin** – rolin e Komisionit
 - **Lajme** – përmbledhje të diskutimeve dhe aktiviteteve të komisionit; të bëhen informatat më shumë se vetëm qëllim e përmbajtje dhe të shtohen diskutimet e citatet nga deputetët. Këto informata, aktualisht të vendosura vetëm në pjesën e "Lajmeve" të faqes kryesore të Kuvendit, duhen ndërlidhur apo lidhur me faqen e Komisionit.
 - **Projektligjet** – Kur propozohen projektligje, të përfshihet legjislacioni dhe ndryshimet e propozuara që Komisioni është duke i shqyrtuar; projektligjet vendosen në një pjesë tjetër të faqes së internetit. Departamenti për Çështje Ligjore dhe Procedurale, me mbështetjen e ZMMP, duhet t'i vendos këto dokumente.

- **Procesverbalet** – Kurdo që të jetë e mundur, procesverbalet e takimeve të komisioneve duhen vendosur në faqe.
 - **Përmbledhjet e dëgjimeve publike** – Lajme të veçanta duhen shkruar, postuar e dërguar kurdo që të mbahen dëgjime publike.
3. **Pyetjet parlamentare dhe interpelancat**– të postohen pyetjet nga deputetët dhe përgjigjet nga Qeveria, si dhe transkriptet nga interpelancat qoftë në seancën plenare ose më vonë, ndaras nga procesverbali. Kjo do të kishte vlerë për gazetarët, hulumtuesit, shoqërinë civile dhe palët tjera të interesuara.
 4. **Kuvendi i shpjeguar** – të shtohet një nyje e re në hyrjen themelore, mbi rolet, funksionin dhe historinë e Kuvendit. Temat e mundshme do të ishin: Deputetët, udhëheqja, Komisionet, orari i deputetit, rregullorja e punës, historia e Kuvendit.
 5. **Rregullorja e punës** – Proceset sipas së cilave Kuvendi zhvillon punën e tij duhet të bëhen publike dhe të jenë lehtë të qasshme.
 6. **Funksioni i kërkimit** – Funksioni i kërkimit në faqe duhet avancuar për ta bërë më të lehtë për mediat, shoqërinë civile dhe publikun e gjerë që të gjejnë informata për Kuvendin.
 7. **Baza e të dhënave e fotografive** – Kuvendi i nxjerr fotografitë e veta dhe i poston ato në faqe në lidhje me ngjarjen, por këto duhet të jenë në dispozicion për shkarkim nga palët e jashtme – sidomos mediat. Kjo do të ishte një arkiv i mirë fotografik për përdorim të mëtutjeshëm në publikimet dhe materialet tjera që krijohen nga Kuvendi.
 8. **Informatat për media** – Parlamentet varen nga gazetarët për informimin e publikut për punën e tyre. Faqja duhet të ketë një pjesë me informata për gazetarë, përfshirë akreditimin, kushtet e punës, fushat e qasjes, etj.
 9. **Vizitat në Kuvend** – Shtoni një rubrikë të re për të njoftuar opinionin se si të parashtrihen kërkesat për vizitë dhe turne në Kuvend, duke përfshirë informatat për kontakt të ZMMP.

C) Përmirësimi i përafrimit me publikun, qasja publike

Duhen filluar aktivitete të përafrimit me publikun, për t'i ndihmuar publikut të gjerë që ta kuptojë më mirë punën e Kuvendit. Këto do të përfshinin publikime të ndryshme dhe cilësore, krijimin e programeve edukative dhe zhvillimin e programeve për përafrim me komunitetin.

Qasja publike në Kuvend gjithashtu duhet të përmirësohet, me një qendër të re të informimit publik dhe ofrimin e transmetimeve të drejtpërdrejta në internet/televizion.

Publikimet

Të rimodelohet buletini javor i Kuvendit ashtu që të bëhet më i rregullt në kohë dhe të krijohen "fletë informuese" për t'ia shpjeguar publikut punën e Kuvendit.

Derisa ka disa publikime më të vjetra në dispozicion në faqen e Kuvendit, ka pak dokumente që prodhohen rregullisht dhe freskime me qëllim të edukimit dhe informimit të publikut.

Këto publikime të propozuara –revistat dymujore dhe fletët informuese – do të vendosen në faqen e Kuvendit, mund t'i shpërndahen mediave dhe të ofrohen si vegla edukuese. Publikimet ndihmojnë në përkufizimin e prioriteteve, imazhit dhe mesazhit të Kuvendit. Të gjitha botimet do të vendosen në ueb faqen e Kuvendit.

1) Revista dymujore

Të rimodelohet buletini i Kuvendit me qëllim të ofrimit të një përmbledhjeje të shkurtër dhe koncize të aktiviteteve të Kuvendit në dy muajt e kaluar

Revista dymujore do të jetë një përzierje në mes të një teme të veçantë (një analizë e thellë e një teme për një çështje) dhe çështjeve aktuale që debatohen në Kuvend, projektligjeve të parashtruara, rezolutave të miratuara, projektligjeve të kthyer në ligje, raportet e komisioneve, vizitat tek komunitetet nga Kryesia dhe deputetët dhe vizitat e rëndësishme në Kuvend. Botimi do të ketë përafërsisht 12 faqe.

2) Fletët informative

Të krijohen "fletët informuese" për Kuvendin.

"Fletët informative" të reja do të shpjegojnë se si funksionon Kuvendi dhe të mbulonin tema si "Kryetari dhe Kryesia e Kuvendit", nga një për secilin komision të përhershëm, funksional dhe të atypëratyshëm, "punën e një deputeti", si hartohen dhe miratohen projektligjet, etj. Këto fletë informative të reja do të ofronin më shumë informata dhe do të shpjegojnë se si funksionon Kuvendi para publikut të gjerë. Secila do të jetë një faqe, me dy fletë, e lehtë për t'u lexuar, me fotografi e grafikë.

Programi edukativ

Të vazhdohet dhe të zhvillohet programi i ri edukativ.

1. **Vizitat publike** për nxënës të shkollave dhe publikun e gjerë janë një element qenësor i të qenit institucion i hapur dhe i qashtëm. Këto duhen vazhduar dhe avancuar me një "Ditë të hapur të Kuvendit", për të hapur edhe më tutje punimet e Kuvendit për studentë.
2. Të zhvillohet një **vizitë virtuale e Kuvendit**, si shëtitje edukative për vizitorët e Kuvendit, ose për aktivitete të përafërimit me komunitetin. Kjo duhet vendosur në faqen e internetit të Kuvendit.
3. Të ndërtohet një **udhëzues për të rinjtë** për të shpjeguar rolet dhe funksionet e Kuvendit në një gjuhë më të lehtë për popullatën e re. Ky udhëzues do të përdorej si vegël edukative për nxënës që vizitojnë Kuvendin dhe ngjarjet që organizohen nga deputetët në shkolla e komunitete.
4. të krijohet një seri **video-xhirimesh** për të shpjeguar rolet dhe funksionet e Kuvendit. Temat e mundshme janë: një ditë e zakonshme pune e një deputeti, Kryesisë, Komisioneve, si bëhet një ligj dhe historia e Kuvendit. Video-xhirimet mund të vendosen në ueb faqen e Kuvendit, në Qendrën Informative për Vizitorët, si dhe mund të përdoren për veprimtaritë e sensibilizimit të komunitetit.

5. Të shikohen mundësitë e prodhimit të një **programi javor parlamentar** për televizion, që do të përqendrohej në veprimtaritë parlamentare, duke përmbledhur ngjarjet e javës së kaluar, ligjet e reja, intervistat me anëtarët e Kryesisë, kryesuesit e komisioneve, kryetarët e grupeve parlamentare dhe deputetët, si dhe do të theksonte mesazhet që Kuvendi dëshiron t'ia përçojë publikut. Programi do të shërbente si mjet për të theksuar dhe përsëritur mesazhin e tij.

Përafrimi me komunitete

Kuvendi duhet të ndërtojë një program për përafrim me komunitetin, duke edukuar grupet e komuniteteve, grupet civile dhe lagjet e ndryshme lidhur me Kuvendin, dhe mënyrën se si veprimtaria e tij ndërlikohet me familjet dhe komunitetet.

Programi për përafrim me komunitetin do të delegonte personelin e Kuvendit që të shpjegojë se si funksionon Kuvendi, përmes trajnimeve të grupeve të shoqërisë civile, ose seminareve të shkurtra me publikun e gjerë në lagjet e tyre.

Një projekt i suksesshëm është "Java e Kuvendit", ku Kryetari i Kuvendit, apo ndonjë deputet tjetër, shkon në një komunë të caktuar për t'u takuar me publikun. Ky aktivitet duhet të vazhdojë.

Kuvendi duhet të shfrytëzojë plotësisht **zyrat rajonale të deputetëve**, pas themelimit të tyre, si pika kontakti për aktivitetet e përafrimit me publikun. ZMMP-ja duhet të ofrojë mbështetje për t'u siguruar që këto zyra – do të pajisjen me materiale të shtypura, të sigurojnë funksionimin e një kompjuteri të dedikuar dhe të lidhur me faqen e internetit të Kuvendit dhe të mbështesë deputetët në takimet e tyre me elektoratin, mbajtjen e debateve, organizimin e ngjarjeve, etj.

Një ide tjetër për t'u marrë parasysh:

Një program i "Përafrimit me Kuvendin", i cili e afron Kuvendin më afër njerëzve, duke organizuar seanca shpjeguese për punën e Kuvendit, duke demonstruar rëndësinë e Kuvendit (me theks në çështjet lokale) në zonën e tyre dhe duke punuar me grupe lokale të shoqërisë civile për t'i ndihmuar komisioneve të organizojnë vizita.

Bashkëpunimi me Shoqërinë Civile

Institucionalizimi i bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit dhe Shoqërisë Civile.

Me pjekurinë e shoqërisë civile, ajo do të fillojë të ushtrojë presion dhe të influencojë institucionet qeveritare të Kosovës. Meqë dialogu është i rëndësishëm, kuvendi duhet të bëjë përpjekje për të siguruar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në proceset e hartimit të ligjeve dhe atë të mbikëqyrjes së zbatimit të tyre, si dhe të ndihmojë në ngritjen e vetëdijes së publikut rreth aktiviteteve të kuvendit. Ky proces kërkon nga një anë

dialog të vazhdueshëm në nivelin politik, si dhe në anën tjetër krijimin e infrastrukturës institucionale.

Më 2012, Kuvendi krijoi Zyrën Koordinatave, e cila ka për detyrë që në koordinim me Zyrën për Media dhe Marrëdhënie me Publikun të punojë me shoqërinë civile.

Për të ndërtuar urat e bashkëpunimit me shoqërinë civile kuvendi duhet që të:

1. Themeloj një grup punues të përbashkët ndërmjet shoqërisë civile dhe anëtarëve të kuvendit, përfshirë edhe kryesin e kuvendit, e cila do të përfshihet në dialog me përfaqësuesit e shoqërisë civile. Grupi punues do të takohet rregullisht me përfaqësuesit e shoqërisë civile për të negociuar një zgjidhje parlamentare, parimet e bashkëpunimit duke marrë në konsideratë parimet e strategjisë së bashkëpunimit ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile.
2. Diskutojë projekt rezolutën ose deklaratën e mirëkuptimit në një konferencë gjithëpërfshirëse të kuvendit dhe shoqërisë civile në 2013. Zyrtari për Marrëdhënie me Shoqërinë Civile në Zyrën Koordinatave do t'i udhëheqë këto aktivitete.
3. Krijimi i një **baze të dhënave të shoqërisë civile**-regjistrimi i gjithë ekspertizës së ofruar nga shoqërisë civile në punën e komisioneve dhe të kuvendit, përdorimi i së cilës mundëson informimin e shoqërisë civile rreth mbledhjeve të komisioneve dhe seancave plenare, si dhe evidentimin e organizatave të cilat mund të ndihmojnë kuvendin në aktivitetet arsimore dhe promovuese. Baza e të dhënave e shoqërisë civile do të administrohet nga personeli i Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Qendra e informimit për vizitorë

Qendra e informimit për vizitorë do të themelohet në Kuvend.

Qendra e informimit për vizitorë do të organizojë vizita publike, të jepte përgjigje për pyetjet nga qytetarët dhe të ofronte informata në lidhje me Kuvendin dhe veprimtarinë e tij. Qasja fizike në Kuvend dërgon një porosi të rëndësishme për publikun, në kuptimin që ai funksionon në transparencë të plotë, është në dispozicion të të gjithëve dhe në thelb, ekziston për të mirën publike.

Transmetimi televiziv

Të avancohet transmetimi, duke shtuar transmetime elektronike të seancave plenare, takimeve të Kryesisë dhe Komisioneve.

Seancat plenare të Kuvendit të Kosovës transmetohen drejtpërdrejt deri në ora 17:00 gjatë seancave; komisionet nuk mbulohen. Plani strategjik i veprimit të Kuvendit të Kosovës parasheh një kanal të ri televiziv parlamentar. Ky qëllim afatgjatë krijon implikime të mëdha në kuptimin e stafit dhe buxhetit.

Kuvendi do të përfitonte në afat të shkurtër dhe të mesëm duke **i dhënë prioritet transmetimit në internet** të seancave plenare dhe takimeve të komisioneve. Lidhjet

me transmetimin elektronik dhe programin ditor automatikisht paraqiten në faqen e Kuvendit. Sigurisht që në fillim do të kishte kosto për blerjen dhe instalimin e pajisjeve, por një sistem që mbulon të gjitha sallat e takimeve do të mund të vendosej më shpejt si dhe do të ishte më efektive në kosto në kuptimin e mirëmbajtjes.

D) Përmirësimi i marrëdhënieve me media

Marrëdhëniet me mediat janë aspekt themelor i secilës zyrë të komunikimit. Mediat i mundësojnë Kuvendit të arrijë tek një audiencë më e gjerë, në kohën e duhur, me mesazhe specifike.

Për Kuvendin, ZMMP duhet të jetë agresive (e përkushtuar për të arritur te publiku) dhe të kërkojë ofrimin e informatave bazë jo-politike për punimet e Kuvendit dhe aktivitetet e Kryesisë.

ZMMP-ja tanimë i kryen funksionet bazë të një zyre shtypi të legjislativit. Ajo duhet të përdorë edhe një numër veglash tjera për të ofruar informata mbi të gjitha aktivitetet e Kuvendit.

Konferencat për shtyp

Aktivitetet e Kuvendit duhen theksuar nga ZMMP-ja përmes konferencave për shtyp të organizuara dhe të publikuara mirë. Kjo do të përfshinte edhe paralajmërimet publike të ndryshimeve apo përmirësimeve në faqen e Kuvendit; shpalljen e mundësive të reja të qasjes publike, si qendra e re e informimit publik, apo shpalljen e publikimeve të reja.

Kuvendi duhet ta krijojë praktikën sipas të cilës, pas secilit takim të kryesisë apo komisionit, kryesuesi apo një person i caktuar e jep një deklaratë. Mediat mund të jenë të pranishme, derisa ZMMP-ja mund ta hartojë deklaratën e shtypit për të përçuar thelbin e vërtetë të rendit të ditës dhe vendimeve të marra.

Takimet e shkurtra në sfond

Me kërkesë të komisioneve, ZMMP-ja mund të promovojë punën e komisioneve përmes takimeve të shkurtra të organizuara në sfond. Këto takime jozyrtare ndërmjet komisioneve, mediave, dhe shoqërisë civile do të ndihmonin në theksimin e çështjeve me të cilat ballafaqohet komisioni, derisa ai trajton një projektligj apo një raport mbikëqyrës.

Dhoma e mediave

Të përmirësohet shfrytëzimi i hapësirës dhe të rritet mundësia që shtypi të ketë qasje në atë dhomë

Qasja e mediave në Kuvendin e Kosovës është përgjithësisht e mirë. Gazetarët kanë qasje në sallat e Kuvendit, sallat e Komisioneve dhe te vetë deputetët. Dhoma e punës së mediave është e mjaftueshme, por mund të përmirësohet me anë të:

1. rritjes së qasjes në dhomën për masmedia gjatë të gjitha ditëve të punës.

2. Rehabilitimi i një këndi, me logon e Kuvendit apo ndonjë shenjë zyrtare në prapavijë, ashtu që mediat të bëjnë intervista në këmbë me deputetët para atyre shenjave.
3. vendosjen e një stende nga ZMMP-ja për vendosjen e publikimeve të Kuvendit.
4. hapjen e hyrjes së pasme të Kuvendit për përfaqësuesit e masmediave.

Kuvendi dhe ZMMP-ja duhet gjithashtu të marrin parasysh **hapjen e më shumë hapësirave** në të cilat mediat mund të intervistojnë deputetët, si për shembull aty ku është një prej kthinave anësore në zonën e korridorit. Kjo hapësirë gjithashtu mund të pajiset me shenja zyrtare të Kuvendit, për të theksuar vendin si pikë për intervista. Në planin afatmesëm kjo do të përfshinte krijimin e një hapësire të re për deputetët për mbajtjen e konferencave për shtyp/takimeve të shkurtra në sfond.

Njoftimi i gazetarëve me praktikat parlamentare

Të organizohen kurse njoftuese për gazetarët e rinj që mbulojnë Kuvendin dhe çështjet legjislative mbi atë se si funksionon Kuvendi.

Sigurimi i njoftimit të gazetarëve për praktikat parlamentare do t'i udhëzojë raportuesit e rinj mbi atë se si të mbulojnë Kuvendin dhe do t'i njoftojë ata me procedurat e Kuvendit. Seancat duhet të përqendrohet tek çështjet praktike se si parashtrohet një projektligji, roli i komisioneve, si të qasen informatat në lidhje me dhe nga Kuvendi, çështjet protokollare, roli mbikëqyrës i Kuvendit, etj. Këto kurse do të organizoheshin në baza tremujore.

E) Zhvillimi i kapaciteteve

Të ofrohet trajnim për personelin e ZMMP-së në shkrim profesional/efektiv, të angazhohet një administrator i përhershëm i faqes dhe të hartohet një listë e shërbimeve për deputetët.

Kapaciteti komunikues i Kuvendit të Kosovës është i kufizuar, por ka një bazë të fortë për përmirësim.

1. I gjithë personeli i ZMMP-së duhet të përfitojë nga **trajnimi në punë në lidhje me shkrimin efektiv**, ashtu që të sigurohet që puna e tyre të jetë e pastër, bindëse dhe e strukturuar mirë.
 - Trajnimi duhet të jetë me mentor në vendin e punës.
 - Kjo përpjekje duhet të përfshijë edhe koordinorët e Komisioneve, të cilët duhet ta mbështesin si Kuvendin ashtu edhe ZMMP-në, pasi që ato informata mbi komisionet e tyre i dërgohen mediave dhe vendosen në sferën publike.
2. E gjithë ZMMP-ja duhet të ketë një lloj trajnimi për **aftësi fotografimi** në vendin e tyre të punës
3. Me marrjen përsipër të detyrës nga Kuvendi për përmirësimin e faqes së internetit, **të angazhohet një administrator faqeje/dizajner grafik** i cili do të udhëhiqte procesin e bërjes së faqes së internetit më miqësore për shfrytëzuesit. Me rolin e dyfishtë si dizajner grafik, ky personel i ri do të përfshihej në botimet e Kuvendit.

4. Të sigurohet që të gjitha informatat publike të **përkthehen me kohë** në gjuhët zyrtare të Kuvendit. Nëse shërbimet e përkthimit brenda kuvendit nuk janë në dispozicion, atëherë duhet të shqyrtohet mundësia e kontraktimit të shërbimeve profesionale të përkthimit.
5. ZMMP duhet të krijojë një listë të shërbimeve të saja për deputetët, duke ofruar të dhëna për rolin e ZMMP, organizimin e konferencave për shtyp dhe ngjarjeve tjera publike, se si të kontaktohen masmediat, informata për të folurit në publik, etj.

II. Prioritizimi i veprimeve

Derisa të gjitha elementet e planit të informimit dhe përafrimit me publikun janë të rëndësishme për sukses, disa aspekte mund të mos jenë të mundura për shkak të kufizimeve financiare apo kufizimeve në aspektin e kapaciteteve. Përmirësimet në vijim janë renditur sipas rëndësisë.

Veprimet kyçe:

Në vijim janë veprimet kyçe dhe ato duhet të zbatohen përpara të gjitha përmirësimeve tjera.

1. **Miratoni një mesazh kyç** – një mesazh kyç është thelbësor për unifikimin e Kuvendit të Kosovës rreth një teme të përbashkët dhe do të shërbente si gur themel për të gjitha produktet e komunikimit.
2. **Shtoni rrjedhën e informacionit** – sasia, cilësia dhe afatet e informatave që vihen në dispozicion nga Kuvendi për opinionin duhet të përmirësohen. Përmirëso dhe racionalizo ueb faqen.
3. **Përmirësoni marrëdhëniet me masmediat** – shpërndajë komunikata të rregullta për shtyp për rendin e ditës dhe funksionimin e Kuvendit.

Thekso punën e mirë të Kuvendit nga miratimi i ligjeve deri tek puna e komisioneve. Organizo konferenca të rregullta për shtyp dhe sftime raportimi.

Veprimet e rekomanduara:

Këto veprime janë të rëndësishme dhe duhet të zbatohen për të konsoliduar kapacitetin e komunikimit të jashtëm të Kuvendit. Ato kërkojnë investimin e burimeve dhe bashkërendimin me zyrat e tjera në Kuvend.

1. **Përmirëso përafrimin me publikun** – përmirëso përafrimin me publikun duke botuar një buletin javor, duke botuar një seri të fletëve informative dhe duke shndërruar revistën e Kuvendit në një botim tematik dymujor. Incizo video për rolin dhe funksionet e Kuvendit.
2. **Përmirëso qasjen publike** – puno ngushtë me shoqërinë civile për të promovuar dhe pasur dialog. Hap një qendër për informimin e vizitorëve dhe zbato një program të rregullt të vizitave të drejtuara. Krijë një program për sensibilizimin e komunitetit duke u përqendruar në atë se si punon Kuvendi dhe punët në interesin e publikut.

3. **Përkthimi me shkrim** – siguro që të gjitha informatat publike përkthehen me shkrim me kohë në të gjitha gjuhët zyrtare të Kuvendit.
4. **Ndërtimi i kapaciteteve të ZMMP** – personeli i ZMMP shton shkathtësitë në fotografi dhe efikasitet. Angazho një administrator të ueb faqes/dizajner grafik.

Veprimet fakultative

Këto veprime janë të rëndësishme por mund të zbatohen pasi që të përfundohen veprimet kyçe dhe të rekomanduara.

1. Përmirëso marrëdhëniet me masmediat përmes seancave informative për praktikat parlamentare.
2. Përmirëso përafrimin me publikun duke zbatuar transmetimin e drejtpërdrejt në ueb faqe të seancës plenare, mbledhjeve të kryesisë dhe komisioneve.
3. Puno me transmetuesin publik për të hartuar një program javor televiziv që përqendrohen në çështjet parlamentare.
4. Angazho një kompani të marrëdhënieve me publikun për të ndihmuar në zhvillimin dhe zbatimin e produkteve të sensibilizimit të publikut dhe veprimtarive të sensibilizimit të komunitetit.

III. Afati i Zbatimit të Projektit

Veprimet kryesore janë në ngjyrën e gjelbër

Veprimet e rekomanduara janë në ngjyrën e verdhë

Veprimet fakultative janë në ngjyrën e kaltër

| Zhvillimi i mesazhit kryesor për kuvendin | | | | | |
|--|--|---|--------------------------------|--|----------------------------|
| Detyrat | Përgjegjës | Indikatorët | Afati | Komentet | Implikimet buxhetore |
| Zhvillimi i mesazhit thelbësor i cili do të shërbej në komunikimet e kuvendit. | Kryesia e Kuvendit dhe Grupet Parlamentare | Grupet punuese për diskutimin e mesazhit thelbësor Aprovimi i mesazhit thelbësor dhe vënia në përdorim në të gjitha botimet, në ueb faqe, në fjalime | shtator 2013 tetor 2013 | Të udhëhiqet nga ZMMP bashkëveprim me Sekretariatit e Kuvendit, përfshirë Departamentin për çështje ligjore dhe procedurale Diskutime nga ana e udhëheqëseve të kuvendit në ngjarje të ndryshme | Nuk ka implikime buxhetore |

| Shtimi i rrjedhës së informacionit | | | | | |
|---|---|--|---|--|--|
| Detyrat | Përgjegjësia | Indikatorët | Kohëzgjatja | Komentet | Implikimet buxhetore |
| Përmirësimi i ueb faqes së kuvendit, që të jetë më gjithëpërfshirëse dhe më e lehtë për përdorim. | Administrata e Kuvendit, Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun | Krijimi i grupit punues për vlerësimin e ueb faqes për nevojat e informacionit nga ana e Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun. Grupi punues rekomandon ndryshimet dhe plotësimet në bazë të strategjisë së propozuar ZMMP harton (së bashku me kompaninë e kontraktuar) ndryshimet teknike dhe krijimin e | prill 2013 maj 2013 qershor 2013 korrik-shtator 2013 | ZMMP bashkë me Sekretariatit e Kuvendit, Departamentin për çështje ligjore dhe procedurale, Zyra për pranimin e kërkesave, të menaxhoj të dhënat nga gjithë administrata e kuvendit, dhe koordinatoret e komisioneve Grupi i punës të diskutojë për pozitë e administratorit të ueb faqes dhe përgjegjësitë e | Nuk ka implikime buxhetore, përjashtimisht nëse angazhohet një uebmaster nga jashtë. |

| | | | | | |
|--|--|---|----------------------------------|---|--|
| | | formatit. Kuvendi lanson ueb faqen e re Azhurnimi i ueb faqes së kuvendit | nëntor 2013 Në vazhdimësi | zyrës (kush kontribuon çka dhe ku mbetet nisma) Konferenca për shtyp për të shpallur ueb faqen e azhurnuar. Deputetët, masmedia, shoqëria civile bëjnë një vizitë virtuale(online) | |
|--|--|---|----------------------------------|---|--|

Përmirësimi i fushatave promovuese, si dhe i qasjes nga ana e publikut

| Detyrat | Përgjegjës | Indikatorët | Afati | Komentet | Implikimet Buxhetore |
|---|-----------------------------------|---|---|--|----------------------------|
| Kuvendi të publikoj një buletini të ri dymujor (që zëvendëson buletin e Kuvendit) | ZMMP | Marrëveshja rreth formatit dhe përmbajtjes të buletinit të kuvendit Fillimi i botimit | shkurt 2013 mars 2013 | Rreth 5,000 kopje në të tri gjuhët, kostoja rreth €2,500 për edicion | €30,000 |
| Zhvillimi i një publikimi të ri- fletëve informuese | ZMMP, Koordinatorët e Komisioneve | Zhvillimi i listës së fletëve informuese Pajtueshmëria rreth formatit dhe përmbajtjes së fletë-informimeve Fillimi i publikimit | dhjetor 2012 shkurt 2013 maj 2013 | Pas publikimit të çdo fletëpalosjeje, kuvendi duhet të njoftoj publikun përmes mediave, dhe varësisht nga temat mund të organizojë edhe konferenca shtypi. Fletëpalosjet mund të publikohen çdo dy-ti javë. | €5,000 |
| Krijimi i programit edukativ- vizitë virtuale | | Në proces e sipër Vizita virtuale paraqitet në ngjarjen për botimin e strategjisë për | korrik 2012 tetor 2012 | Vizitë virtuale krijuar në bashkëpunim me OSBE-në. | Nuk ka implikime buxhetore |

| | | | | | |
|---|---|--|---|--|--|
| | | marrëdhëniet me publikun | | | |
| Zhvillimi i programit edukativ-video mbi funksionin dhe rolin e kuvendit. | ZMMP, Administrata e Kuvendit | Hartimi i listës me videot që duhen zhvilluar Kontaktim I kompanive për marrëdhënie me publikun për vlerësimin e realizueshmërisë dhe mbi konceptin. | në fillim të vitit 2013 | Koncepti duhet të përfshihet në propozim buxhetin e vitit 2013 | € 3-5,000 për një video |
| Krijimi i programit edukativ – shfaqje një orëshe mbi parlamentin | ZMMP, Zyra e Sekretarit negocion me RTK | Inicimi i kontaktit me RTK-në për program një orësh një here në javë | në mes të vitit 2013 | Transmetimi të filloj në fund të vitit 2013 | TP |
| Program arsimor edukativ –udhëzues për rininë | ZMMP | Takimi me grupet rinore dhe organizatat qytetare me orientim rinor për të vlerësuar nevojë dhe llojin e udhëzuesit | vonë në vitin 2013 | Udhëzimi mund të jetë në formë të publikimit apo të videos | TP |
| Sensibilizimi i komunitetit | Kryesia e Kuvendit, Grupet Parlamentare | Hapja e Zyrave (Parlamentare) të Kuvendit nëpër Komuna Njofto deputetët për përfitimet e sensibilizimit të komunitetit Vlerësimi i realizueshmërisë të aktiviteteve, shiqo modelet e fushatës promovuese Të sigurohet që zyrat të jenë të paisura me publikime dhe tavolina pune. Të ftohen mediat lokale për vënien e marrëdhënieve reciproke | në fillim të vitit 2013 në fillim të vitit 2014 në fillim të vitit 2014 në fillim të vitit 2014 në fillim të vitit 2014 | Në harmoni me Planin Strategjik të Kuvendit, objektiven 8.1 Kuvendi duhet të organizoj evenimentin me rastin e hapjes së akëcilës zyrë. €7,000 | €40,000 (Të propozohet në gjatë rishqyrtimit të buxhetit në mes të vitit 2012) |

| | | | | | |
|--|---|---|----------------------------------|---|--|
| | | Takime rajonale me struktura komunale dhe qytetarë. | në fillim të vitit 2015 | | |
| Bashkëpunimi me shoqërinë civile –baza e të dhënave | ZMMP | Inicimi i bazë të dhënave mbi shoqërinë civile Mirëmbajtje bazën e të dhënave | korrik 2012 në vazhdimësi | | Nuk ka implikime buxhetore |
| Bashkëpunimi me shoqërinë civile – dialogu politik | Kryesia e Kuvendit, deputetët e interesuar, administrata e Kuvendit, Zyrtaari për marrëdhënie me shoqërinë civile, ZMMP (mbështetja logjistike) | Themelo grupin punues politik për të zhvilluar dialogun strategjik Organizo takime të rregullta të grupit | nëntor 2013 në vazhdimësi | | Nuk ka implikime buxhetore Veprimtaria të mbështetura nga donatorët |
| Bashkëpunim me shoqërinë civile – Forumin e OJQ-ve | Administrata deputetët e interesuar, administrata e Kuvendit, Zyrtaari për marrëdhënie me shoqërinë civile, ZMMP mbështetja logjistike) | | Vjetore, më së voni 2013 | Kuvendi do të bashkëpunoj me shoqërinë civile në të gjitha fazat e planifikimit. | Të përcaktohet (Veprimtaria të mbështetura nga donatorët) |
| Qendra për Informim të Vizitorëve | ZMMP | Hapja e Qendrës së Vizitorëve Furnizimi dhe pajimi i zyrës Shpallja e publikimeve | shtator 2012 | | (Veprimtaria të mbështetura nga donatorët) |
| Ngritja e transparencës së kuvendit përmes ueb-transmetimit të drejtpërdrejtë (live) të seancave, mbledhjeve të kryesisë dhe të komisioneve. | Administrata e Kuvendit, seksioni i TI i mbështetur nga ZMMP | Vlerësimi i praktikës së ueb-transmetimit të aktiviteteve parlamentare dhe i teknologjisë së nevojshme për instalim dhe funksionimin e ueb- | 2013 | Nevojitet miratimi i Kryesisë për të ndërruar prioritetet Në përputhje me synimin 8.1 të planit strategjik të kuvendit | 10.000 euro 300.000 euro |

| | | | | | |
|--|--|---|-------------------------|--|--|
| | | transmetimit. Blerja e pajisjeve | në fillim të vitit 2014 | (ndërrimi i kahjes së fondeve nga TV në vlerësimin e transmetimit elektronik) | |
| | | Transmetim i drejtpërdrejtë i seancave, dhe mbledhjeve të komisionit. | Kah mesi i vitit 2013 | Ndërro transmetimin e sallës plenare në transmetimin përmes internetit, blej dhe instalo pajisjet në sallën e kontrollit dhe deri në tetë salla (kryesia dhe komisionet) | |

| <i>Përmirësimi i Marrëdhënieve me Media</i> | | | | | |
|--|--|---|--|---|----------------------------|
| Detyrat | Përgjegjës | Indikatorët | Afati | Komentet | Implikimet buxhetore |
| Konferenca për shtyp | Kryesia, kryesuesit e komisioneve, ZMMP | Konferenca për shtyp pas takimeve të rregullta javore | në vazhdimësi | | Nuk ka implikime buxhetore |
| Përmbledhje informative | Kryesuesi i komisionit dhe deputetët, ZMMP | Pajtimi për fillimin e përmbledhjeve informative për media dhe shoqërinë civile në baza të rregullta. | në vazhdimësi | ZMMP, Koordinatorët e Komisioneve bashkëpunojnë ngushtë për të planifikuar përmbledhjet | Nuk ka implikime buxhetore |
| Përmirësimi i hapësirës së mediave | Mbështetur ZMMP | Zgjatja e orarit për hapësirën për media, krijo mënyra për të siguruar që hapësira është e hapura gjatë gjithë orarit të punës së Kuvendit Krijimi i hapësirës për intervista me qëndrim në këmbë. Shtimi i raftëve për publikime | shkurt 2013 mars 2013 prill 2013 | | €400 €100 |
| Arsimimi i gazetarëve | ZMMP | Takimi me gazetarë për | në fillim të vitit 2013 | Do të sigurohet në baza | Nuk ka implikime |

| | | | | | |
|----------------------|--|---|-----------------------|-----------|-----------|
| për punën e Kuvendit | | të diskutuar çështje me interes Krijimi i sesioneve informuese | në fund të vitit 2013 | tremujore | buxhetore |
|----------------------|--|---|-----------------------|-----------|-----------|

Ndërtimi i Kapaciteteve

| Detyrat | Përgjegjës | Indikatorët | Afati | Komentet | Implikimet Buxhetore |
|---|----------------------------------|---|---|---|----------------------------|
| Trajnimi i stafit të ZMMP-së | Administrata e Kuvendit | Trajnim mbi shkathtësitë në të shkruar Trajnim mbi teknikat e fotografimit | shtator 2013 dhjetor 2013 mars 2013 tetor 2013 | Ushtrimi i shkrimit do të ndihmojnë përmirësimin e kualitetit të komunikatave, publikimeve, dhe informatave tjera Ngritja e kualitetit të fotografive, meqë kuvendi krijon databazën e fotografive Në harmoni me Planin Strategjik të Kuvendit, objektiva 8.1 | €5,000 |
| Krijimi i listës së shërbimeve për deputetët. | ZMMP, Administrata e Kuvendit | ZMMP-ja publikon listën e shërbimeve që i ofron kuvendit. | në fund të vitit 2012 | | Nuk ka implikime buxhetore |
| Rekrutimi i një grafik dizajneri profesional për ueb faqe | Administrata e Kuvendit, ZMMP | Harto fushëveprimin e pozitës së punës Rekrutimi i një grafik dizajneri për ueb faqe | gusht 2013 qershor 2013 | Në harmoni me Planin Strategjik të Kuvendit, objektiva 8.1 | €3,000/në vit |
| Shërbimi i Përkthimit | Administrata e Kuvendit, ZMMP | Azhurnim i përkthimit të publikimeve dhe ueb faqes në gjuhën serbe dhe angleze | Në vazhdimësi | Në harmoni me Planin Strategjik të Kuvendit, objektiven 8.1 Kuvendi duhet ta marrë në konsideratë angazhimin nga jashtë për të realizuar përkthimet në | €10,000/në vit |

| | | | | | |
|--|--|--|--|--------------------------------|--|
| | | | | kohë të të gjitha publikimeve. | |
|--|--|--|--|--------------------------------|--|